



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 8111

Tirane, date 15/12/2015

Drejtuar: Z. DASHAMIR GEGA
SHOQERIA "SHEBENIKU" SHPK
LIBRAZHD

QARKU ELBASAN

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z. RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.266 date 23.04.1996.

I nderuar z. Gega,

Shoqëria "Shebeniku" shpk është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.266 date 23.04.1996 për mineral kromi, ne objektin "Kudenishti Lindor", Librazhd, ne Qarkun Elbasan.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr. 8150 date 07.09.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.6025 date 08.09.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.266 date 23.04.1996 për mineral kromi, ne objektin "Kudenishti Lindor", Librazhd, ne Qarkun Elbasan, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2014-2015 dhe për vitin 2015-2016. Nga verifikimi qe është bere nga ana jone rezulton se ju keni kryer pagesa pjesore dhe jo vlerën e plote vjetore prej 219 320 leke te përcaktuar sipas Urdhrit te Ministrit nr.135 date 28.02.2012 "Për miratimin e garancisë financiare për realizimin e planit te rehabilitimit te mjedisit për lejet e shfrytëzimit".

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në gërmen “ç” të pikës 1 të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa me sipër në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.266 datë 23.04.1996 për mineral kromi, në objektin “Kudenishti Lindor”, Librazhd, në Qarkun Elbasan**, që shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.266 datë 23.04.1996 për mineral kromi, në objektin “Kudenishti Lindor”, Librazhd, në Qarkun Elbasan.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

